



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW**



**PSH. Nr. 837/17**

**PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT** i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 36 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01/2017, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga autoriteti kontraktues (AK) “Korporata Energjetike e Kosovës”, për diskualifikim dhe marrje të masave ndaj Operatorit Ekonomik “Ve Mor”-Pejë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave, gypave të kracerit”, me numër të prokurimit: “16/145/221”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) / Korporata Energjetike e Kosovës /, më: 26.10.2017 mori këtë:

**V E N D I M**

**I.Refuzohet**, si e pa bazuar, kërkesa e Autoritetit Kontraktues (AK) - “Korporata Energjetike e Kosovës”, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE “Vemor”-Pejë, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: “Pastrimi i kanalizimeve dhe pusetave, gypave të kracerit”, me numër të prokurimit: “16/145/221”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) / Korporata Energjetike e Kosovës /.

## ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues / Korporata Energjetike e Kosovës / me dt: 29.09.2017, ka parashtruar kërkesë në OSHP, që të shqyrtohen mundësit e veprimit konform nenit 99 të LPP-së, për diskualifikim dhe marrje të masave ndaj OE “Ve Mor”- Pejë, si anëtar i konsorciumit “Er Lisi & Ve Mor”.

Lidhur me këtë kërkesë ekspertja shqyrtuese ka përgatitur një kronologji dhe ia ka dorëzuar panelit shqyrtues me dt:06.10.2017.

Përkitazi me kërkesën e lartpërmendur OSHP-ja ka caktuar seancë dëgjimore me dt: 26.10.2017 për shqyrtim dhe vlerësim, ku prezent kanë qenë paneli shqyrtues, ekspertja e OSHP-së, përfaqësuesi i AK-së dhe përfaqësuesi i OE-së.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK – KEK z. deklaroi: “Neve na ka ardh email nga OE Kastrati se referencat e OE Erlis&Vemor nuk i ka në rregull. Fjala është për aktivitetin e prokurimit Pastrimi i Kanalizimeve Teknologjike dhe pusetave, gypave të kracerit me nr.prok.16/145/221. OE Kastrati ka dyshuar se një referencë e OE Erlis është referencë e dyshuar. Ne si AK kemi ndërmarr veprimet dhe përmes emailit i jemi drejtuar Birrarisë së Pejës, dhe të njëjtit në përgjigje kanë deklaruar se referenca ku Vemor kinse ka kryer punë në kompleksin e fabrikës së Birrarisë nuk është e lëshuar nga ne. I njëjti OE nuk ka kryer punë tek ne. Duhet të ju njoftoj se i njëjti person nga Birraria e Pejës me datë 26.10.2017 përmes emailit ka thënë se “Po ka kryer punë, mirëpo jo për vitin 2017 por për vitin 2016” .

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE “ErLis&VeMor” z.Morina deklaroi: “Unë tek dje kam kuptuar se çka është duke ndodhur, lidhur me kërkesën e AK-KEK. Për referencën e kontestuar nga AK, unë dje e kam noterizuar. Me përgjegjësi e them se referenca në fjalë është e lëshuar nga Birraria e Pejës”.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z.Bullatovci deklaroi: “Nuk kam çka të shtoj më shumë nga ato që kam thënë në kronologjinë e përgatitur për këtë lëndë”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK z.Mexhuani deklaroi: “Kërkojmë nga paneli shqyrtues të aprovoj kërkesën e AK-KEK”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Morina deklaroi: “I propozojmë panelit shqyrtues të refuzoj ankesën e AK-KEK, pasi siç u konstatuar edhe në seancën e sotme, pretendimi i AK është i paqëndrueshëm dhe i pabazuar”.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, analizës konkrete, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se lidhur me referencën e prezantuar nga operatori ekonomik “Ve Mor”- Pejë, ka dhënë përgjigje dhe e ka konfirmuar Birraria e Pejës me dt:26.10.2017 se ky operator ekonomik ka kryer punë në vitin 2016, edhe pse fillimisht Birraria-Pejë kishte sqaruar se referenca nuk ishte lëshuar nga ana e tyre. Prandaj duke u bazuar në dëshmitë e lartpërmendura paneli shqyrtues konsideron se është e pa bazuar kërkesa e autoritetit kontraktues për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE “VEMOR”- Pejë, pasi që nuk ka arritur të dëshmojë se operatori ekonomik “Vemor”-Pejë ka ofruar dëshmi të rrejshme apo të falsifikuara.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - “Korporata Energjetike e Kosovës”

1x1 OE - “ER-Lisi & Ve-Mor” - Pejë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.